



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0303

Paneli Shqyrtues, i emëruar, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga panelisti individul, Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së OE “BK – Construction” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it- Ritender LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Bogë Ritender” me numër të prokurimit 635-25-1938-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, më 24/06/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjeserisht e bazuar ankesa e OE “BK – Construction” SH.P.K. me nr. 2025/0303, e datës 28/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-Ritender LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Bogë Ritender”, me numër të prokurimit; 635-25-1938-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Komuna e Pejës.
2. Mbetet në fuq, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Pejës për aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-Ritender LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Bogë Ritender”, me numër të prokurimit; 635-25-1938-5-2-1.
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, OE “BK – Construction” SH.P.K., sipas nenit 31.4 të Rregullorës OSHP-së. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Pejës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 14.03.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Participim me projektet

e DEMOSI-it-Ritender LOT 1-Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Bogë Ritender”, me numër të prokurimit 635-25-1938-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 99,930.00€

AK me datën 10.04.2025 ka publikuar Njoftimi mbi vendimin e për dhënie të kontratës OE “Termomontimi”.

Me datën 11.04.2025, OE “BK – Construction” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për qasje në AK. OE “BK – Construction” SH.P.K me datën 15.04.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. AK me datën 16.04.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 28.04.2025 operatori “BK – Construction” SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0303 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 12.05.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi për dhënie të kontratës.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “BK – Construction” SH.P.K

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Pejës, ju, njofton se ankesa e parashtruar nga ana juaj më datë 15.04.2025 nuk mund të merret parasysh dhe është e pa bazuar për shkak të faktit se ne dosje te tenderit është kërkuar 30.1 Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët, duke mos favorizuar apo diskriminuar një apo me shume operatorë.

Kemi vlerësuar dosjen e tenderit me përpikëri duke analizuar dhe bazuar në pranueshmerinë e operatoreve ekonomik, përshtatshmërinë profesionale, kapacitetin ekonomik dhe financiar, kapacitetin teknik dhe profesional sa i përket ISO Certifikatës së prodhuesit, Operatori ekonomik sipas deklaratës nën betim si dhe Deklaratës së Specifikimeve Teknike që i qëndron prapa gjitha dokumentacioneve të kërkuara nga autoriteti kontraktues, tek paramasa dhe parallogaria.

Sipas Rregullores Nr 001-2022 për prokurim publik Neni 7 pika 7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

- a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se;
- b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se;

Operatori ekonomik Termomontimi ka bërë kërkesë për sekrete afariste Aneksi 3, dhe janë të cekura edhe në formularin për tërheqje të dokumentacionit Dokumentet që nuk dorëzohen për shkak të trajtimit si sekret afarist janë: 1. Qarkullimi bankar 2. Kontratat e nënshkruara me palët e treta (psh. Inxhinier ose furnitorë të tjerë) me c'rast në datën 11.04.2025 përfaqësuesi juaj është njoftuar me aktin dhe të njëjtin e ka nënshkruar. Sipas pro fakturës 02/09 të datës 19.02.2019 Emërtimi: Traktor Eskavator i përdorur me rrota tip MF 860.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "BK – Construction" SH.P.K në ankesën Nr. 0303/2025 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë i OE ankues: Siç shihet është kërkuar në oferte vizatimi rrethë shtyllës, si dhe certifikatën ISO të prodhuesit. Operatori ekonomik nuk ka bërë një gjë të tillë. As nuk ka paraqitur certifikatën, dhe as nuk ka paraqitur vizatimin. Kuptohet që në pararmasë kërkohen specifikat teknike të cilat duhet secili OE të ju përmbahet për të ofruar një shërbim sa më specifik dhe profesional. Gjithashtu, Paramasa është pjesë e Dosjes të Tenderit. Dhe në të njëjtën kohë përpilohet duke i respektuar Specifikat Teknike të DT. Në këtë rast OE nuk i ka respektuar të gjitha specifikat teknike të parapara në dosje të tenderit. Ndërkaq, AK-ja duke mos reaguar mbi këtë kërkesë të paraqitur nga ana e saj ka shpirtë drejt një vlerësimi jo të duhur meqrast është shkelur neni 59.

Pretendimi i dytë i OE ankues: Kërkesa tjetër e cila nuk na është trajtuar mjaftueshëm ishte për pajisjen e paraqitur nga OE i favorizuar nga AK në këtë rast si fitues. Në kërkesë 3 tek F T D, 9.1 & 9.2 kërkesa mbi mundësitë teknike dhe profesionale. OE fitues ka paraqitur një pajisje në fakturën e blerjes emërohet si Traktor-ekskavator i përdorur masfreguson MF 860. Ajo çka është shënuar në faturë nuk i përkon fotografisë që është paraqitur. Behet fjalë për dy pajisje të ndryshme.

Pretendimi i tretë i OE ankues: Përveç kësaj në FTD është kërkuar edhe plani dinamik, pasi që në pikën 5.2 janë dhënë afatet kohore për fillim dhe mbarim të punimeve. OE i përzgjedhur fitues asnjë deklaratë që pajtohet me afatet kohore për fillim dhe mbarim të punimeve nuk ka paraqitur dhe as me pak një plan dinamik. Në kushte tjera nëse nuk do kishim paraqitur një dokument të tillë do të ishim të diskualifikuar. Ndërkaq AK ka vendosur të heshte në këtë rast tek OE i favorizuar/ përzgjedhur si fitues. Dhe të mos kthejë asnjë replikë rreth kësaj në kërkesën për rishqyrtim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0303/2025, i cili është dorëzuar me datë 12/05/2025.

Lidhur me pretendimet e OE "BK - Construction SH.P.K." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0303 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: "Participim me projektet e DEMOSI-it-RITENDER LOT 1- Ndertimi i ndriçimit publik Shkrel-Bogë RITENDER" me nr. të prokurimit: "635-25-1938-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm. AK me datë 10/04/2025 publikon njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, letrën standarde B58, i cili rekomandon për kontratë OE Termomontimi SHPK ndërsa OE ankues shpallet i pasuksesshëm. Operatori ekonomik i pakënaqur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat dhe se shkelë Ligjin për Prokurimi Publik përkatësisht nenin 59 dhe bebet 40.6 dhe 40.13 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022.

Përgjigje në pretendimin e pare ankimor: Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në FDT nuk ka kërkuar të bashkëngjitet as katalog sipas paramasës e as ISO standarde, andaj Operatorët ekonomik nuk mund të eliminohen për kërkesa që nuk kanë qenë pjesë e FDT-së, sipas nenit 56.3 të Ligjit për Prokurim Publik. Dhe rrjedhimisht ISO standardet, katalogu dhe kërkesat relevante vendosen ne FDT. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.

3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përgjigje në pretendimin e dytë: Ekspertja shqyrtuese pretendimin e dytë e gjenë të pa bazuar për faktin se, në ofertën e OE të rekomanduar gjendet DUD doganor me të gjitha të dhënat si në pro fature dhe fature gjithashtu përputhen shumat, ndërsa sa i përket fotos përkundër që AK nuk ka kërkuar foto në DT, specifikat M860 ekskavator janë pikërisht e njëjta si në foto.

Kërkesa 3: Mekanizmi dhe mjetet e punës te ofruara nga OE 1.) Min. 4 (katër) Automjete me shportë Speciale për punë në ndriçimin publik, 2.) Min. 3 (tre) Kamioneta për bartjen e materialit dhe punëtoreve, 3.) Min. 1 (një) Pick Up, 4.) Min. 1 (një) Kamion, 5.) Min. 1 (një) eskavator me goma 8 – 9 ton. 6.) Min. 1 (një) aparat saldimi; 7.) Min. 1 (një) gjenerator; 8.) Min. 1 (një) demolues betoni (hilt).

Dëshmia 3: Lista e pajisjeve dhe mekanizimit te OE, te vulosura dhe te nënshkruara te dëshmuar me libreza valide regjistrimi. Nga pika 1 – 5 te dëshmuar me libreza regjistrimi valide, kurse nga pika 6 - 10 te dëshmohen me dud doganor ose fature blerje. Paisjet duhet të jenë në emër të kompanisë ose marrëveshje për marrje me qira e noterizuar. Së paku për 2 autoshporta OE duhet te ofroje raportet teknike te inspektimit të noterizuara nga një kompani e licencuar për inspektim (te prezantohet licenca për inspektimit).

Përgjigje në pretendimin e trete ankimor: Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në DT askund nuk ka kërkuar që të bashkëngjitet Plani Dinamik, andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar për faktin se AK konform nenit 56.3 të DT-së nuk mund të eliminoj asnjë ofertues për kërkesat që nuk kanë qenë paraprakisht në dosje të tenderit, ndërsa në DT pika 5.2 AK ka paraqitur afatin kohor për fillimin dhe mbarimin e punëve.

Rekomandimi e ekspertit shqyrtues;

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaj operatori ekonomik nuk është deklaruar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar e të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE BK – Construction” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i

ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “BK – Construction” SH.P.K, janë të pa bazuara.

Paneli shqyrtues pasi që analizon raportin e ekspertizës dhe sqarimin e dhënë në pretendime ankimore sqaron se është i paqëndrueshëm pretendimi i Ankuesit (me të dhëna si në shkresat e lëndës) se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i ka respektuar të gjitha specifikat teknike të parapara në dosje të tenderit, nuk ka paraqitur certifikatën, dhe as nuk ka paraqitur vizatimin, sepse AK në FDT nuk ka kërkuar të bashkëngjitet as katalog sipas paramasës e as ISO standarde, andaj Operatorët ekonomik nuk mund të eliminohen për kërkesa që nuk kanë qenë pjesë e FDT-së, sipas nenit 56.3 të Ligjit për Prokurim Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kërkesën 3 tek F T D, 9.1 & 9.2 kërkesa mbi mundësitë teknike dhe profesionale, më saktësisht nuk ka paraqitur një pajisje në faturën e blerjes emërohet si Traktor-ekskavator i përdorur masfreguson MF 860, është i paqëndrueshëm, sepse në ofertën e OE të rekomanduar gjendet DUD doganor me të gjitha të dhënat si në pro fature dhe fature ku dhe përputhen shumatat, ndërsa sa i përket fotos përkundër që AK nuk ka kërkuar foto në DT, specifikat M860 ekskavator janë pikërisht e njëjta si në foto, e që edhe në këtë pikë aplikohet neni 5.3 i LPP-së (AK nuk mund të eliminojë një OE për kërkesa që si ka paraparë në DT).

Paneli shqyrtues e konsideron të pabazuar pretendimin e Ankuesit se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka bashkëngjitur një deklaratë që pajtohet me afatet kohore për fillim dhe mbarim të punimeve dhe nuk ka paraqitur plan dinamik, sepse AK në DT nuk ka kërkuar që të bashkëngjitet Plani Dinamik. AK konform nenit 56.3 të DT-së nuk mund të eliminojë asnjë ofertues për kërkesat që nuk kanë qenë paraprakisht në dosje të tenderit, ndërsa në DT në pikën 5.2 AK ka paraqitur afatin kohor për fillimin dhe mbarimin e punëve, andaj Paneli shqyrtues i gjen pretendimet ankimore ja të paqëndrueshme në LPP.

Paneli shqyrtues vren se ankuesi në Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, OE ankues është njoftuar nga Autoriteti kontraktues se tenderi i tij nuk ishte me çmim me të ulët, përkundër faktit që ka plotësuar të gjitha kërkesat e Dosjes së tenderit dhe pedantrisht ka bashkëngjitur të gjitha dokumentet e nevojshme sipas ffolderve dhe kërkesave të DT, që është për vlerësim të operatorit ekonomik.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbetet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i datës, 10.05.2025, për shpërblim me kontratë të OE “Termomontimi” për aktivitetin e prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Komuna e Pejës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Participim me projektet e DEMOSI-it-Ritender LOT 1-Ndertimi i ndricimit publik Shkrel-Bogë Ritender” me numër të prokurimit ;635-25-1938-5-2-1. K.Pejë.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat

dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishëm të ankesës të OE "BK – Construction" SH.P.K, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - BK - CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: